



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME



Npi – 01/114 datë: 05.06.2026

Për: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
Divizionin për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit,

Nga: Rrahman Jakupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes,

Lënda: **KËRKESË PËR SQARIM SHITESË JURIDIK LIDHUR ME KËRKESËN PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT NR. NPI-01/74 PËR RIZGJEDHJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe në Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, paraqes këtë kërkesë për sqarime shitesë juridike lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të Vendimit Nr. Npi-01/74 për rizgjedhjen e Komitetit për Komunitete.

I. KRONOLOGJIA E ÇËSHTJES

1. Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 05.03.2026, ka miratuar Vendimin Nr. Npi-01/35 për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete.

Provë: Vendimi Nr. Npi-01/35, datë 05.03.2026.

2. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes Kërkesës për Rishqyrtim Nr. 020-210-12-2026, datë 07.04.2026, ka vlerësuar se akti nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ka kërkuar rishqyrtimin e tij.

Provë: Shkresa Nr. 020-210-12-2026, datë 07.04.2026.

3. Me qëllim të respektimit të kërkesave ligjore dhe sigurimit të përfaqësimit të drejtpërdrejtë të komuniteteve jo-shumicë, Kryesuesi i Kuvendit z.Rrahman Jakupi ka organizuar takim publik me banorët, komunitetet e komunës së Shtimes për nominimin e përfaqësuesve të tyre në Komitetin për Komunitete.

Provë: Procesverbali i takimit, lista e pjesëmarrësve

4. Në takimin publik kanë marrë pjesë përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë, të cilët kanë propozuar kandidatët për përfaqësim në Komitetin për Komunitete.

5. Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e tretë të rregullt të mbajtur më 30.04.2026, ka shqyrtuar kërkesën e MAPL-së për rishqyrtim dhe duke u bazuar në propozimet e komuniteteve nga takimi publik, me shumicë votash ka miratuar Vendimin Nr. Npi-01/74 për rizgjedhjen e Komitetit për Komunitete.

Provë: Vendimi Nr. Npi-01/74, datë 30.04.2026.

6. MAPL, përmes shkresës Nr. 020-346/4, datë 04.06.2026, ka kërkuar sërish rishqyrtimin e Vendimit Nr. Npi-01/74, me arsyetimin se ai nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Provë: Shkresa Nr. 020-346/4, datë 04.06.2026.

II. ÇËSHTJET JURIDIKE QË KËRKOJNË SQARIM

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të datës 04.06.2026, vlerësoj se arsyetimi i paraqitur nga MAPL nuk trajton në mënyrë të plotë rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret. MAPL mbështetet në nenin 53.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas të cilit çdo komunitet që jeton në komunë duhet të përfaqësohet në Komitetin për Komunitete, në arsyetim mungon analiza lidhur me mënyrën e zbatimit të kësaj dispozite në rastet kur numri i komuniteteve tejkalon numrin e vendeve të parapara për përfaqësuesit e komuniteteve në Komitet. Po ashtu, nga arsyetimi i paraqitur nuk rezulton se MAPL ka bërë ndonjë analizë të proporcionalitetit të komuniteteve sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë, e as nuk rezulton se ka analizuar ndikimin që mund të ketë përjashtimi i komuniteteve me numër dukshëm më të madh të pjesëtarëve në favor të komuniteteve me përfaqësim numerik simbolik. Ndërsa Komiteti për Komunitete përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, prej të cilëve tre (3) janë anëtarë të Kuvendit dhe katër (4) janë përfaqësues të komuniteteve.

Sipas të dhënave zyrtare të Regjistrimit të Popullsisë 2024, në Komunën e Shtimes janë evidentuar:

- 732 pjesëtarë të komunitetit Ashkali;
- 17 pjesëtarë të komunitetit Rom;
- 10 pjesëtarë të komunitetit Boshnjak;
- 1 pjesëtar i komunitetit Egjiptian;
- 1 pjesëtar i komunitetit Turk.

Provë: Popullsia sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në nivel vendi dhe komune për vitet 2011 dhe 2024, dokument nga ASK, dokument i qasur më 05.06.2026)

Në procedurën e rishqyrtimit të Vendimit Nr. NPI-01/74, Kuvendi i Komunës së Shtimes ka zbatuar në mënyrë të plotë nenin 9 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, duke siguruar që propozimi i kandidatëve për Komitetin për Komunitete të bëhet drejtpërdrejt nga vetë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, përmes një procesi konsultativ. Pra, në rastin konkret, kandidatët janë propozuar drejtpërdrejt nga vetë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, jo si në rastin e parë. Në këtë kontekst, çdo propozim adresuar përmes subjekteve politike nuk mund të konsiderohet shprehje e drejtpërdrejtë e vullnetit të komunitetit, pasi subjektet politike

përfaqësojnë interesa partiake të kufizuara dhe jo domosdoshmërisht përfaqësimin gjithëpërfshirës të komunitetit përkatës dhe rrjedhimisht, Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka siguruar një proces të drejtpërdrejtë, duke garantuar legjitimitetin komunitar të nominimeve dhe përputhshmërinë e plotë me qëllimin substancial të UA Nr. 05/2020. Andaj në bazë të gjithë që u shënuan më sipër, kërkoj:

1. Cila është baza juridike dhe cilat dispozit konkrete e legjislacionit në fuqi konsiderohet e shkelur në rast të kontestimit të përbërjes së Komitetit për Komunitete, dhe mbi cilën bazë juridike mund të ngrihet një kontestim i tillë ndaj vendimit të Kuvendit të Komunës Npi-01/74?
2. Si duhet të interpretohet dhe zbatohet neni 53.1 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në rastet kur numri i komuniteteve jo-shumicë në komunë tejkalon numrin e vendeve të parapara për përfaqësim në Komitetin për Komunitete, dhe cilat janë kriteret juridike që duhet të udhëheqin këtë përfaqësim?
3. A duhet të merret parasysh parimi i proporcionalitetit dhe struktura reale demografike e komuniteteve sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë gjatë përcaktimit të përbërjes së Komitetit për Komunitete, dhe a mund të konsiderohet si më përfaqësues një kandidat që nuk është propozuar drejtpërdrejt nga komuniteti përkatës dhe nuk ka marrë pjesë në procesin konsultativ të organizuar nga Kuvendi?
4. Në mungesë të një norme eksplicite ligjore që i jep prioritet propozimeve të kanalizuaras përmes subjekteve politike, mbi cilën bazë juridike mund të konsiderohet më përfaqësues një kandidat i propozuar jashtë procesit të drejtpërdrejtë konsultativ të komunitetit, dhe si arsyetohet përputhshmëria e një qasje të tillë me parimin e përfaqësimit të drejtpërdrejtë të komuniteteve jo-shumicë?
5. Në rastet kur komuna ka organizuar proces konsultativ për nominimin e përfaqësuesve të komuniteteve, por nga një komunitet i caktuar nuk paraqitet asnjë kandidat dhe nuk jepet asnjë propozim për ta, cili është obligimi juridik i Kuvendit të Komunës për të siguruar përfaqësimin e atij komuniteti dhe mbi çfarë baze ligjore mund të emërohet një përfaqësues pa propozim nga vetë komuniteti?

Duke qenë se këto çështje janë thelbësore për procedurën e rishqyrtimit dhe për vendimmarrjen e Kuvendit, në mbledhjen e radhës që do të mbahet në fund të muajit qershor 2026, kërkoj nga MAPL që të ofrojë sqarime shtesë juridike lidhur me çështjet e ngritura më sipër. Kuvendi i Komunës së Shtimes do ta trajtojë kërkesën për rishqyrtim në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, sigurisë juridike, përfaqësimit demokratik dhe autonomisë lokale.



Kryesuesi i Kuvendit
Rahman Jakupi